



Pranuar / Dorezuar Primitjena / Prilato Received / Delivered	09.11.2022	2	viti god year
Organ / Shpjestia Organ / Jedinitca Org / Unit	Br Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHUK	6743/2022		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 813/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani, kryetar Jeton Koca, dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 813 /2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi nga Komuna e Klinës, kundër organit të punësimit Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr. 813/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 21.09.2022, me numër protokolli 5544/2022, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, për ngritje e koeficientit nga koeficientit pesë pikë pesë (5.5), në koeficient gjashtë pikë pesë (6.5).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Financave Punës dhe Transfereve. Ndërsa Këshilli me datë 17.10.2022, ka pranua nga Ministria e Punës dhe Transfereve, Përgjigjen në kërkesë me numër protokolli: 6259/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 813/2022 të datës 21.09.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 16.03.2022; Kërkesë e datës 13.06.2019, për Harmonizimin e koeficienteve; Akt Emërimi i datës 08.02.2012; Diplomë e datës 16.03.2021; Lista e pagave; Përgjigje në ankesë e datës 31.10.2022, me numër protokoll 6578/2022, me shkesat e bashkangjitur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pa mundur, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, ka bërë administrimin e provave të lëndës përkatësisht Akt Emërimin të datës 08.02.2012, ku është konstatuar se ankuesi mbanë pozitën „ Nëpunës i Pensionove dhe Benficioneve”, me të cilin është paraparë koeficienti pesë pikë pesë (5.5)

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në mbështetje të nenit 103 paragrafit 1 nën të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”*, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën A.nr.813/2022 pasi që ankuesi përmes kërkesës së datës 04.11.2022 të dërguar përmes imellit ka kërkuar tërheqjen e ankesës.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
LËNDA ME NUMËR A.NR. 813/2022

Rushit KAJTAZI



Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

Ankuesit

Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve;

Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve; dhe

Arkivit të KPMSHCK-së;

